

8JH-1

M 78

BESNIK
MUSTAFAJ

Fytyrë burri



8JH-1

141 98

Besnik
Mustafaj



BIBLIOTEKA E QEBETHIT
GJURKASTER
50812

**Fytyrë
burri**

POEZI

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»



Abetarja

*Aty ku duhej të mbaronte botë e
përrallave,
aty u shfaqe ti.*

*Sepse ne s'duhej të mbeteshim gjithmonë
fëmijë...*

*Për të mos humbur, për të mos u rrëzuar
në të përpjetat ku do të na ngjisje ti,
në faqen e parë, me buzë në gaz,
na priti Enveri...*

Unë jam pjesë e rrugës sime

Eci në rrugën që kam nisur. Gjymtyrët e
mi lëvizin
natyrshëm, në harmoni të plotë me
ndërrimin e shpeshtë
të peizazhit, me ndërrimin kalendarik të
stinëve,
me ndërrimin e papritur të motit;
në harmoni të plotë
me fytyrat e bashkëkohësve që më kalojnë
në krahë.

Rrobat s'mi bëhen dot trupit maskë!

Ju flas juve që më njihni; ju lutem, në më
doni vërtet,
mos më kërkoni të njëtrajtshëm,
s'mund të jem i tillë!

Në ecje bart në vete pak nga ikja e verës,
i jap asaj si dhuratë e si peng
dhimbjen e ditës që mbyllet,

iku duke lënë tek unë
monumentin e punës së vet të pavdekshme;
siç ia marrsh kujdesjen lumit, seriozitetin
malit,
pa ngurrim ia lë rininë time një nëne
dëshmori
që me sy të rrëmbushur më thërret «bir».

Fytyrën e kam pasqyrë të dashurive të
gjakut.

Më shihni si qesh e si vrenjtem, lavdëroj e
shaj.

Mos ju ngjaj i panatyrshëm?!
Jam si bota përreth, si stinët, si peizazhi, si
moti,
eci e i bart në vete të gjitha: të keqen e
vdekshme
e të mirën që shkon para,

gëzimin e dhimbjen e lindjes, dashurinë
dhe urrejtjen.

Ndaj, ju flas edhe juve që s'më njihni,
në më doni vërtet,
mos më kërkoni të njëtrajtshëm, jam si
rruga ku eci,
me trup të zakonshëm si dheu
e njëkohësisht të ylbertë.

Skicë nga një pasdite dimri në Kurbnesh

Bën ftohtë, shumë ftohtë.
Edhe duke ndenjor
e ndien nevojën e shokut.
Dy duar s'e mbështillkan dot njëra-tjetrën,
as nga era dy duar
s'të mbrokan dot.

...Minatorët nga katër e nga pesë
hyjnë e dalin në kafe...
Me krismën e të qeshurës së çlirët
ia thyejnë ditës akullin...

Këngë dashurie në vjeshtë

sipas ritit të lashtë

Si ndodhi kështu?!

*I thonë vjeshtë e dytë,
po vjeshta nuk duket askund;
as gjethe të rëna,
as bar i tharë,
as re.*

*Në vjeshtë si në vjeshtë:
duhet patjetër diçka,
e mrekulluar prej bukurisë së vet,
të vdesë.*

*Sonte ky jam unë.
Ë pashë, e pashë, e pashë
varrin tim të madh në sytë e tu.*

*Të lutem, e dashur, thuaju njerëzve
s'i erdhi vdekja, e thirri ai.
I mrekulluar nga çasti kur ishim bashkë
shkoi vetë t'i bëhej vjeshtës kurban.*

Lulet prej letre

kundër artit ornamentalist

Lulet prej letre: të kuqe, të verdha.

*Në ngjyrat e tyre s'është dielli,
s'është dheu, s'është shiu, s'është vesa,
s'është dita as nata,
s'është hijedrita e reve,
s'është kufiri i pacaktuar mes stinëve,
as lulëzimi
për të mësuar se s'janë thjesht lule,
as formimi i mundimshëm i frutit
ku zbulohet dashuria e vërtetë e njerëzve,
as fara për të kuptuar gëzimin e dhimbshëm
të nënës
që pa ngurrim vetëmohohet
dhe trupin e saj*